



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Ekstra: 1

Tiranë – E hënë, 6 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 7527, datë 11.12.1991	Për shërbimin ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë..... 3
Ligj nr. 7528, datë 11.12.1991	Për funksionet e Këshillit të Mbrojtjes dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë..... 9
Ligj nr. 7529, datë 11.12.1991	Për shfuqizimin e ligjit nr. 7383, datë 8.5.1990, “Për gjykatat shoqërore”.. 11
Ligj nr. 7530, datë 11.12.1991	Për organizimin e Shërbimit Informativ Ushtarak dhe të Shërbimit të Kundërzbulimit në organet e Rendit Publik..... 11



LIGJ

PËR SHËRBIMIN USHTARAK NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese” me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga ushtria, nga forcat e Rendit Publik, të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe ato territoriale.

Neni 2

Forcat e Armatosura kanë detyrë kryesore mbrojtjen me çdo kusht të lirisë, të pavarësisë kombëtare dhe të tërësisë territoriale të vendit, si dhe të rendit kushtetues. Për to atdheu është i shenjtë, kufijtë e tij janë të paprekshëm, interesat e popullit janë mbi gjithçka.

Neni 3

Organizimi dhe veprimtaria e Forcave të Armatosura bazohen në Kushtetutë, në ligjet dhe në aktet nënligjore.

Neni 4

Ushtria është forca kryesore për mbrojtjen e Atdheut. Ajo, në raste të caktuara, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes, kryen detyra në interes të popullsisë civile dhe të ekonomisë.

KREU II SHËRBIMI USHTARAK

Neni 5

Me hyrjen në shërbimin ushtarak, ushtarakët bëjnë betimin me formulimin si vijon:

“Si shtetas dhe si pjesëtar i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, betohem se do të zbatoj kërkesat e Kushtetutës e të ligjeve dhe do të jem kurdoherë ushtar besnik i popullit

tim, luftëtar i denjë, vigjilent, trim e i disiplinuar, i gatshëm në çdo çast që edhe me jetën time të mbroj interesat e larta të Atdheut.

Ndëshkimi më i rëndë i ligjeve le të më jepet, në goftë se shkel këtë betim solemn. Betohem!”.

Neni 6

Shtetasit shqiptarë, kudo që ndodhen, janë të detyruar të kryejnë shërbimin ushtarak aktiv ose rezervist në Republikën e Shqipërisë. Shërbimi ushtarak kryhet personalisht.

Neni 7

Shërbimi i detyrueshëm paraushtarak kryhet nga shtetasit e moshës 16 vjeç deri në thirrjen e tyre për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv.

Mënyra e organizimit dhe e zhvillimit të shërbimit të detyrueshëm paraushtarak, përcaktohet me vendim të Këshillit të Mbrojtjes.

Neni 8

Shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv kryhet nga shtetasit e moshës 18 deri 27 vjeç.

Në rast mobilizimi të përgjithshëm, mund të thirren për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv edhe shtetasit që kanë mbushur moshën 17 vjeç.

Neni 9

Shërbimi i detyrueshëm ushtarak rezervë kryhet nga shtetasit e moshës deri në 50 vjeç, pasi kanë kryer shërbimin ushtarak aktiv ose e kanë kaluar moshën 27 vjeç pa kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv.

Për nevojat e mbrojtjes kryejnë shërbim ushtarak rezervë edhe shtetasit shqiptarë të moshave 18–30 vjeç.

Nga ky shërbim përjashtohen shtetasit shtatzëna dhe ato që kanë fëmijë të moshës deri 8 vjeç.

Në rast mobilizimi të përgjithshëm, mosha e shërbimit të detyrueshëm ushtarak rezervë rritet në përshtatje me situatat dhe nevojat e forcave të Armatosura. Kufijtë e rritjes së kësaj moshe caktohen me dispozita të veçanta të Këshillit të Mbrojtjes.

Neni 10

Shërbimi në forcat territoriale kryhet nga shtetasit e moshës 45 deri në 55 vjeç, si dhe shtetasit e moshës 18 deri në 30 vjeç, që nuk



bëjnë pjesë në forcat e shërbimit ushtarak rezervë.

Nga ky shërbim përjashtohen shtetasit shtatzëna e që kanë fëmijë të moshës deri në 8 vjeç.

Neni 11

Thirrja për kryerjen e shërbimit paraushtarak, të shërbimit ushtarak aktiv, në rezervë dhe në forcat territoriale fillon nga 1 janari i vitit që shtetasi ose shtetasja mbush moshën e caktuar në ligj, dhe zgjat gjer më 31 dhjetor të vitit kur plotësohet afati i mbarimit të shërbimit përkatës.

Neni 12

Shtetasit shqiptarë të moshës 16–27 vjeç, edhe kur nuk janë lajmëruar, detyrohen të paraqiten vetë në degën ushtarake përkatëse për regjistrim, pajisje me librezë ushtarake dhe mobilizim.

Neni 13

Shtetasi që është vënë në thirrje për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, nuk pajiset me pasaportë për jashtë shtetit.

Kur nuk është vënë në thirrje dhe do të largohet jashtë shtetit, shtetasi para largimit detyrohet të nënshkruajë me degën ushtarake përkatëse, kontratën për kohën e kryerjes së këtij shërbimi.

Neni 14

Rezervistët që lejohen të dalin jashtë shtetit për punësim ose për arsye të tjera mbi një vit, detyrohen të paraqiten në përfaqësitë përkatëse konsullore ose diplomatike për t'u marrë në evidencë. Këto të fundit bëjnë veprimet për marrjen në evidencë dhe, brenda 60 ditëve, njoftojnë Ministrinë e Mbrojtjes.

Neni 15

Koha e shërbimit ushtarak në Forcat e Armatosura është:

a) Për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv 15 muaj, kurse për studentët që mbarojnë shkollat e larta civile me shkëputje nga puna, 6 muaj;

b) Për shërbimin e detyrueshëm ushtarak rezervë, 10 ditë për oficerët dhe 7 ditë për rezervistët, në dy vjet;

c) Për shërbimin e detyrueshëm paraushtarak 3 ditë në vit.

ç) Për shërbimin ushtarak të forcave territoriale, 5 ditë për oficerët dhe 3 ditë për efektivin, në dy vjet.

Në rast mobilizimi të pjesshëm ose të përgjithshëm, koha e shërbimit ushtarak mund të zgjatet nga organi që ka vendosur mobilizimin.

Neni 16

Ministria e Mbrojtjes, e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ Kombëtar kanë të drejtë të thërrasin rezervistë (oficerë, nënoficerë e ushtarë) në kurse të shkurtra përgatitjeje e kualifikimi deri në 1 muaj, por jo më tepër se 3 muaj gjithsej për krejt periudhën e shërbimit ushtarak rezervë.

Neni 17

Dega ushtarake, në bazë të dokumenteve të organeve lokale të pushtetit e të administratës shtetërore dhe të organeve të tjera kompetente, pezullon përkohësisht nga thirrja për kryerjen e shërbimit ushtarak aktiv shtetas me gjendje jo të mirë ekonomiko-familjare në familjet e tyre.

Neni 18

Me vendim të komisionit ushtarak të thirrjes dhe të transportimit nën armë, përjashtohen nga shërbimi ushtarak shtetas që, deri në kufijtë e plotësimi të moshës 27 vjeç, kanë në familjet e tyre pjesëtarë të paaftë për punë, të cilëve u duhet shërbyer në këto raste;

a) Kur kanë të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes të paftë për punë;

b) Kur kanë 3 a më shumë pjesëtarë të familjes të paftë për punë dhe 1 të aftë për punë.

Quhen të paftë për punë për efekt të këtij ligji fëmijët nën 15 vjeç, nxënësit deri në 18 vjeç, kur vazhdojnë shkollat e mesme, pjesëtarët e familjes me moshë, gratë mbi 60 vjeç e burrat mbi 65 vjeç dhe pjesëtarët e tjerë të familjes të paftë për punë që, në bazë të raporteve mjekoligjore, e kanë të nevojshme t'u shërbehet.

Neni 19

Thirrja e shtetasve për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe caktimi në armët e shërbimet e Forcave të Armatosura bëhet nga degët ushtarake. Koha e thirrjes nën armë dhe lirimi i tyre nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak bëhet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.



Për përcaktimin e aftësisë fiziko-shëndetësore dhe kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, rezervë e paraushtarak, pranë degëve ushtarake krijohen komisione, përbërja dhe detyrat e të cilave caktohen nga Ministria e Mbrojtjes.

Organet lokale të pushtetit dhe të administratës shtetërore vënë në dispozicion të komisioneve ushtarako-mjekësore personelin mjekësor, pajisjet dhe medikamentet, sipas kërkesave të degëve ushtarake.

Neni 20

Shtetasit që thirren për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, paraqiten në vendin dhe në afatin e caktuar në fletëthirrje.

Me kërkesë të kryetarit të degës ushtarake dhe të komandantit të repartit ushtarak, ata që nuk paraqiten me marrjen e fletëthirrjes, sillen të shoqëruar nga policia ushtarake ose nga policia e rendit.

Neni 21

Shtetasi që është duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, nuk thirret për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv.

Gjykata, kur jep dënim me heqje të lirisë ndaj shtetasve që i nënshtrohen shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, rezervë ose paraushtarak, dhe organet përkatëse që kanë filluar ndjekjen penale ndaj tyre, brenda 10 ditëve, i dërgojnë njoftim degës ushtarake të rrethit që e ka në evidencë shtetasin. Komandantët e reparteve të riedukimit, me lirim të personave të dënuar, njoftojnë degët ushtarake përkatëse.

Degët ushtarake njoftohen nga organet përkatëse edhe në rastet e pushimit të çështjes penale, të ndryshimit të arrestimit si masë sigurimi dhe kur jepet pafajësi.

Kur shtetasi, gjatë kohës së kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, dënohet me heqje të lirisë, me ndalim disiplinor sipas rregullores së disiplinës të Forcave të Armatosura, si dhe kur largohet pa leje nga reparti gjatë kohës së kryerjes së shërbimit, koha e vuajtjes së dënimit penal a disiplinor dhe koha e largimit pa leje nga reparti nuk i llogariten në afatin e kryerjes së shërbimit ushtarak.

Neni 22

Ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv që kanë kryer më shumë se gjysmën e kohës së shërbimit e që për arsye

shëndetësore a shkaqe të tjera të përligjura lirohen para kohe nga ushtria, shërbimi i detyrueshëm aktiv u quhet i kryer.

Lirimi para kohe nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv për ata që deklarohen të paafte për shkaqe shëndetësore, bëhet me vendim të komisionit mjekësor ushtarak epror, kurse për shkaqe të tjera bëhet sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 23

Kryerja e shërbimit ushtarak aktiv për studentët e shkollave të larta ushtarake fillon nga dita e pranimit në shkollë.

Kur ndërpresin studimet për shkaqe të papërligjura dhe afati i kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak nuk është plotësuar, dërgohen për ta plotësuar atë në repartet e ushtrisë.

Neni 24

Shtetasit që studiojnë në shkollat e larta me shkëputje nga puna, brenda dhe jashtë vendit, thirren për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv menjëherë pas përfundimit të studimeve. Ata që nuk përfundojnë shkollën e lartë brenda kufirit të moshës për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, ndërpresin studimet dhe thirren për kryerjen e këtij shërbimi.

Neni 25

Shtetasit që i nënshtrohen shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose rezervë, kur thirren për stërvitje, për forma të tjera të përgatitjes ushtarake dhe për kushtim e mobilizim të pjesshëm a të përgjithshëm, njoftohen nga komandat ose degët ushtarake nëpërmjet organeve lokale të pushtetit e të administratës shtetërore, ndërmarrjeve, institucioneve, organizatave politiko-ekonomike e shoqërore, personave të tjerë juridikë dhe punëdhënësve privatë.

Neni 26

Plotësimi i reparteve ushtarake me rezervistë bëhet si rregull mbi bazë banimi, kurse për specialitete të veçanta me automjete, kafshë e teknikë tjetër të nevojshme dhe mbi bazë qendre pune.



Organet lokale të pushtetit dhe të administratës shtetërore, në bashkëpunim me degët ushtarake dhe komandat përkatëse, detyrohen të organizojnë në bllok, lagje, fshat të bashkuar, fshat të veçantë e në rajon sistemin e lajmërimit me korrier e mjete sinjalizuese për njoftimin dhe paraqitjen e të mobilizuarve në kohën dhe vendin e duhur. Kriteret për organizimin e këtij sistemi përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 27

Ndërmarrjet, institucionet, organizatat politike, ekonomike e shoqërore, personat e tjerë juridikë dhe punëdhënësit privatë përgjigjen për lajmërimin e punonjësve të tyre dhe për sigurimin e paraqitjen e automjeteve, të kafshëve e të teknikës tjetër të nevojshme në kohën e në vendin e kërkuar nga komandat dhe degët ushtarake.

Neni 28

Nuk marrin pjesë në stërvitje, kushtrim ose forma të tjera të përgatitjes ushtarake:

a) Shtetasit pa bashkëshortë e pjesëtarë të tjerë madhorë të familjes, kur kanë fëmijë në ngarkim nën moshën 14 vjeç;

b) Të sëmurët që vërtetojnë paaftësinë e përkohshme me raporte të komisionit mjekësor, të shtruarit në spital, ata që ndodhen me leje të zgjatur shëndetësore ose të paaftë për shërbim ushtarak;

c) Shtetasit që në familjet e tyre kanë pjesëtarë të familjes të sëmurë, të cilët në bazë të raporteve mjekoligjore kanë nevojë për shërbim dhe nuk ka se kush t'u shërbejë;

ç) Të dënuarit me heqje lirie, për gjithë periudhën e vuajtjes së dënimit;

d) Shtetasit shqiptarë me punë në përfaqësitë tona diplomatike ose konsullore në vende të huaja;

dh) Shtetasit që kanë vdekje të pjesëtarëve të familjes.

KREU III

OFICERET DHE NËNOFICERËT

Neni 29

Oficer aktiv i Forcave të Armatosura mund të jetë çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë me figurë të pastër morale, që ka përgatitje ushtarake

ose speciale, në përpunje me detyrën që kryen, me arsim të lartë dhe aftësi fizike.

Kohëzgjatja e shërbimit ushtarak të oficerëve aktivë është deri në 55 vjeç për burrat dhe deri në 50 vjeç për gratë.

Neni 30

Nënoficer aktiv i Forcave të Armatosura mund të jetë çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë me figurë të pastër morale, që ka përgatitje tekniko-profesionale në përshtatje me detyrën e ngarkuar, arsim të mesëm ose të lartë, dhe që ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv, përveç femrave, për të cilat nuk kërkohet një kusht i tillë.

Shtetasit që janë dënuar për përvetësime, falsifikime të dokumenteve zyrtare ose për shpërdorim detyre, nuk merren si nënoficerë aktivë.

Kohëzgjatja e shërbimit ushtarak të nënoficerëve aktivë është deri në 55 vjeç për burrat dhe deri në 50 vjeç për gratë.

Neni 31

Oficerëve dhe nënoficerëve aktivë, vjetërsia e shërbimit ushtarak u llogaritet që nga dita e hyrjes në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë si ushtarë, kursantë ose studentë ushtarakë (në shkollat e larta ushtarake a civile).

Neni 32

Për shërbim shembullor oficerët dhe nënoficerët e shërbimit aktiv mund të dekorohen edhe jashtë radhe.

Neni 33

Oficer dhe nënoficer rezervist mund të jetë çdo shtetas me arsim të mesëm ose të lartë dhe me qëndrim të mirë moral. Ata kryejnë detyra të shërbimit ushtarak në radhët e Forcave të Armatosura në një periudhë kohe të caktuar. Kur nuk caktohen në detyra të tilla, mbahen në evidencë nga degët ushtarake.

Neni 34

Rregullat për titullimin, çtitullimin, emërimin në detyrë të oficerëve e nënoficerëve të shërbimit aktiv, si dhe për transferimin e largimin e tyre, caktohen me ligj të posaçëm.



KREU IV
EVIDENCA USHTARAKE

Neni 35

Degët ushtarake, si organe të mobilizimit, mbajnë dhe krijojnë evidencat e nevojshme me të dhënat që detyrohen t'ua japin organet lokale të pushtetit e të administratës shtetërore, ndërmarrjet, institucionet, organizatat politike, ekonomike e shoqërore, personat e tjerë juridikë dhe punëdhënësit privatë.

Neni 36

Degët ushtarake marrin nga organet lokale të pushtetit e të administratës shtetërore listat e të rinjve që mbushin moshën 16 vjeç, si dhe ndryshimet në përbërjen familjare të shtetasve. Ato evidencojnë e verifikojnë të dhënat e mësipërme, organizojnë kontrollat mjekësore dhe pajisin shtetasit me dokumentet përkatëse ushtarake.

Neni 37

Në rast mobilizimi e luftime, ministritë, institucionet e tjera qendrore, organet lokale të pushtetit e të administratës shtetërore, ndërmarrjet, institucionet, organizatat politike, ekonomike e shoqërore, personat e tjerë juridikë dhe punëdhënësit privatë, për kompletimin e Forcave të Armatosura vënë në dispozicion të organeve të mobilizimit dhe të reparteve ushtarake automjetet, traktorët, së bashku me shoferët e traktoristët, si dhe teknikën tjetër të nevojshme, në bazë të rregullave të përcaktuara nga Këshilli i Mbrojtjes.

Neni 38

Degët ushtarake marrin të gjitha të dhënat e nevojshme në organet e pushtetit, të administratës shtetërore, ndërmarrjet, institucionet, organizatat politike, ekonomike e shoqërore, personat juridikë e punëdhënësit privatë për shtetasit, kafshët, automjetet e teknikën që disponojnë, si dhe të gjitha ndryshimet që pësojnë ato.

Neni 39

Të dhëna të nevojshme, në kuptim të nenit 38 të këtij ligji janë:

- Njoftimet për largimet nga qendrat e punës e të banimit brenda a jashtë rrethit ose jashtë shtetit, ndryshimet që pësojnë shtetasit në aftësinë fiziko-shëndetësore, nivelin arsimor, dënimet, vdekjet e të dhëna të tjera të kësaj natyre.

- Ndryshimet për kafshët e ngarkesës, për mbarështimin, ngordhjet, lëvizjet nga një vend në tjetrin, kalim pronësie, ndërrim të numrit matrikullor, si dhe njoftimet për gatishmërinë teknike të automjeteve e të autotraktorëve, për daljen jashtë përdorimit, për kalimin e tyre nga përdoruesi shtetëror tek ai privat e anasjelltas, si dhe për ndryshime të targave të tyre.

Neni 40

Komandantët e njësisve e të reparteve dhe degët ushtarake organizojnë sistemin e lajmërimit me listëthirrje ose fletëthirrje dhe thërrasin shtetasit rezervistë e paraushtarakë për kryerjen e stërvitjeve të radhës, për prova gatishmërie e kushtim luftarak.

Neni 41

Komandantët e njësisve e të reparteve dhe degët ushtarake verifikojnë e kontrollojnë sistemin e lajmërimit dhe për të metat e vërejtura propozojnë masat e duhura në instancat përkatëse.

Neni 42

Shtetasit që i nënshtrohen shërbimit ushtarak rezervë ose paraushtarak, kur ndryshojnë vendbanimin, qendrën e punës, bëhen të paafte fizikisht për shërbim ushtarak, përgatiten për të dalë për periudha të gjata jashtë shtetit, si dhe kur lirohen nga shërbimi ushtarak aktiv, detyrohen të paraqiten brenda 10 ditëve në degën ushtarake dhe në repartin ku janë inkuadruar për të bërë ndryshimet e evidencës.

Neni 43

Organet shtetërore, ndërmarrjet, institucionet, organizatat politike, ekonomike e shoqërore, personat e tjerë juridikë e punëdhënësit privatë kërkojnë nga punonjësit që i nënshtrohen shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, rezervë e paraushtarak, para se të merren në punë ose të largohen nga puna, të bëjnë ndryshime në evidencën pranë degës ushtarake dhe repartit.

Neni 44

Shtetasit që thirren për të kryer shërbimin ushtarak, për stërvitje, prova gatishmërie e mobilizimi, kurse e forma të kualifikimit ushtarak dhe për kontroll e regjistrim në evidencën ushtarake, detyrohen të paraqiten menjëherë në vendin dhe afatin e caktuar.



Neni 45

Drejtuesit e organeve shtetërore, të ndërmarrjeve e të institucioneve, të organizatave politike, ekonomike e shoqërore, personat e tjerë juridikë e punëdhënësit privatë, detyrohen të lajmërojnë e të mos pengojnë shtetasit për kryerjen e shërbimit ushtarak, për stërvitje, provë gatishmërie ose mobilizimi, kurse e forma kualifikimi ushtarak.

Neni 46

Të gjithë shtetasit që janë në evidencën ushtarake, gjatë stërvitjeve, provave të kushtimit, kryerjes së shërbimit ushtarak aktiv dhe veprimeve me degët ushtarake, duhet të kenë me vete librezën ushtarake bashkë me shenjën personale.

Për dëmtimin dhe humbjen e tyre njoftohet dega ushtarake, e cila bën ripajisjen kundrejt pagesës.

Neni 47

Shkeljet e rregullave të parashikuara në nenet 36–46 të këtij ligji, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në masën 1000–5000 lekë. Gjobat jepen nga komandanti i njësisë ose i repartit autonom, kurse për shtetasit e pacaktuar në reparte ushtarake dhe për drejtuesit e nëpunësit e ngarkuar me mbajtjen e evidencave jepen nga kryetari i degës ushtarake ku është kryer shkelja.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të tij, përkatësisht në komandën më të lartë ose te ministri i Mbrojtjes, i Rendit Publik dhe te kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar, aktet e të cilëve janë të formës së prerë.

KREU V

SIGURIMI MATERIAL E FINANCIAR I
FORCAVE TË ARMATOSURA DHE DISA
TË DREJTA PËR PAGAT E SHPËRBLIMET
PËR USHTARAKËT

Neni 48

Sigurimi material e financiar për plotësimin e detyrave të mbrojtjes së vendit dhe kryerjen e shërbimit ushtarak bëhet nga buxheti i shtetit. Masa e buxhetit për llogari të mbrojtjes caktohet

nga Kuvendi Popullor, në bazë të propozimit të bërë nga Këshilli i Ministrave. Kriteret e përdorimit të fondeve dhe kompetencat përkatëse, përcaktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave.

Neni 49

Sigurimi material e financiar i familjeve të shtetasve të thirrur në shërbim ushtarak në kohë lufte, rregullohet me dispozita të Këshillit të Ministrave.

Përballimi i shpenzimeve për paga, veshmbathje, ushqim etj. të shtetasve që thirren në shërbimin ushtarak aktiv a rezervist në kohë paqeje ose lufte bëhet nga njësitë e repartet ushtarake, në bazë të fondeve financiare të nevojshme të parashikuara si zë i veçantë në buxhetin e shtetit.

Neni 50

Ushtarët, nxënësit dhe studentët ushtarakë të veshur me uniformë udhëtojnë pa pagesë në të gjitha llojet e transportit shtetëror të udhëtarëve brenda vendit.

Neni 51

Ushtarakut, në raste të veçanta, për rezultate shumë të mira në stërvitje e gatishmëri, ruajtjen e administrimin e pronës, si dhe kur kryen detyra me rreziqe e mundime të veçanta për jetën e tij, i jepen shpërblime deri në masën e një page mujore. Masa e shpërblimit caktohet nga komanda e njësisë, institucionit dhe ndërmarrjes ushtarake.

Ushtarakëve, në rast fatkeqësie, vdekjeje ose sëmundjeje të rëndë e të gjatë, të tyre ose të pjesëtarëve të familjes që kanë në ngarkim, si dhe për dëmtimet e pajisjeve të shtëpive nga tërmetet, përmbyset, zjarret etj., u jepet ndihmë e menjëhershme gjer në 1 500 lekë. Ndihmë e tillë mund t'u jepet edhe familjeve të rezervistëve, në rast vdekjeje të rezervistëve gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak, si dhe oficerëve e nënoficerëve që kanë dalë në pension e që kanë punuar për një kohë të gjatë në ushtri. Të drejtën e dhënies së kësaj ndihme e kanë komandanti i njësisë së bashkuar dhe kryetari i Rendit Publik e i Shërbimit Informativ Kombëtar në rreth.



KREU VI
DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 52

Ministri i Mbrojtjes, ai i Rendit Publik dhe kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar nxjerrin rregullore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 53

Koha e stërvitjes ushtarake, e kryer nga studentët që vazhdojnë aktualisht shkollat e larta me shkëputje nga puna, llogaritet në kohën e shërbimit të detyrueshëm ushtarak të tyre.

Neni 54

Për efekt të vjetërsisë së shërbimit në Forcat e Armatosura, ky ligj, ka fuqi prapavepruese për ushtarakët që kanë qenë në shërbimin aktiv nga data 3.7.1991, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7496, datë 3.7.1991, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 55

Për shtetasit që aktualisht kryejnë shërbimin ushtarak aktiv, koha e shërbimit është 18 muaj.

Neni 56

Ligji nr. 5592, datë 15.6.1977, “Për shërbimin ushtarak në Forcat e Armatosura të RPSSH”, shfuqizohet me përjashtim të neneve 25, 26 dhe 27 të tij.

Neni 57

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1992.

Tiranë, më 11.12.1991
Nr. i ligjit: 7527

KRYETARI I KRYESISË
Kastriot Islami

LIGJ

**PËR FUNKSIONET E KËSHILLIT TË
MBROJTJES DHE TË KOMANDANTIT
TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 16 e 32, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Këshilli i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë është organi më i lartë shtetëror kolegjial në fushën e mbrojtjes së vendit. Ai funksionon në kohë paqeje e lufte dhe përgjigjet për drejtimin, organizimin e mobilizimin e të gjitha forcave e mjeteve që shërbejnë për mbrojtjen e vendit.

Neni 2

Këshilli i Mbrojtjes e ushtron veprimtarinë e tij vetëm në bazë të Kushtetutës, të ligjeve dhe të detyrimeve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare e që janë ratifikuar nga Kuvendi Popullor.

Neni 3

Presidenti i Republikës, si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të vendit, udhëheq të gjithë veprimtarinë e tyre në kohë paqeje e lufte.

Këshilli i Ministrave drejton veprimtarinë për plotësimin e detyrave në fushën e mbrojtjes së vendit, në përputhje me vendimet e Këshillit të Mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës para Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Mbrojtjes për drejtimin dhe kontrollin e forcave të ushtrisë dhe për materializimin e politikës së mbrojtjes.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë përgjigjet para Komandantit të Përgjithshëm dhe ministrit të Mbrojtjes për përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake të ushtrisë dhe për drejtimin e organizimin e operacioneve ushtarake të Forcave të Armatosura.

Anëtarët e tjerë të Këshillit të Mbrojtjes ndjekin zbatimin e detyrave në fushën e mbrojtjes dhe të rendit, për sektorët që mbulojnë dhe përgjigjen për zbatimin e tyre.

Neni 4

Këshilli i Mbrojtjes nxjerr vendime dhe udhëzime. Vendimet e Këshillit të Mbrojtjes janë të detyrueshme për ministritë e institucionet e tjera qendrore kur ato kanë të bëjnë me problemet e mbrojtjes së vendit.

Komandanti i Përgjithshëm nxjerr urdhra.



Neni 5

Këshilli i Mbrojtjes ka këto kompetenca kryesore:

1. Përpunon, në përshtatje me politikën e shtetit udhëzimet e përgjithshme ushtarake, organizative e teknike që kanë të bëjnë me përgatitjen e vendit për mbrojtje.

2. Përcakton strukturën organizative të Forcave të Armatosura e të formacioneve të mbrojtjes civile, si dhe limitet e tyre.

3. Vendos për krijimin dhe funksionimin e shtabeve të mbrojtjes në të gjithë territorin e vendit.

4. Përcakton drejtimet kryesore të planifikimit e të ndërtimit të mbrojtjes operativo-strategjike të vendit, të stërvitjes e të gatishmërisë luftarake, të pajisjes materialo-teknike dhe fuqizimit e të modernizimit të Forcave të Armatosura.

5. Përpunon dhe përcakton drejtimet kryesore të zhvillimit të industrisë ushtarake dhe të përgatitjes shtetërore-civile të vendit.

6. Përcakton kompetencat e komandave ushtarake për mobilizimin e efektivave të njërive e reparteve të Forcave të Armatosura për stërvitje e prova kushtrimi, si dhe për lëvizjen dhe vendosjen e tyre jashtë rajonit të dislokimit të përhershëm.

7. Vendos për krijimin dhe shkrirjen e njërive dhe reparteve të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Rendit publik për hallkën batalion e lart.

8. Shqyrton dhe miraton masat për ruajtjen dhe mbrojtjen e rendit publik në rast gjendje të jashtëzakonshme ose lufte.

9. Në rast lufte, agresioni ose sulmi të armatosur kundër vendit tonë ndjek mobilizimin dhe drejton gjithë veprimtarinë e Forcave të Armatosura të organeve shtetërore dhe ekonomike, si dhe të popullatës.

Angazhon dhe vë në dispozicion të frontit të gjitha burimet e mjetet materiale të domosdoshme.

Shqyrton e miraton idetë e vendimeve që përpunon Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë për kryerjen e operacioneve ushtarake.

10. Nëpërmjet Shtabit të Përgjithshëm mbikëqyr veprimtarinë e Forcave të Armatosura dhe të organizmave shtetërore për zbatimin e detyrave të mbrojtjes.

11. I rekomandon Këshillit të Ministrave bërjen e ndryshimeve në buxhetin ushtarak në

vartësi me nevojat për përballimin e gjendjes së luftës ose për krijimin e njërive të reja ushtarake.

12. Shqyrton dhe miraton tekstin e artit ushtarak, rregulloret e disiplinës, të jetës së brendshme dhe të gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura.

Neni 6

Vendimet e Këshillit të Mbrojtjes nxirren kur votojnë për to shumica absolute e anëtarëve të tij.

Anëtarët e Këshillit të Mbrojtjes përgjigjen kolegjisht dhe individualisht për zbatimin e akteve që nxjerr ky Këshill.

Personi i caktuar si anëtar i Këshillit të Mbrojtjes bën pjesë në të për aq kohë sa qëndron në funksionin që përfshihet në këtë organ.

Neni 7

Kryetari i Këshillit të Mbrojtjes cakton datën, rendin e ditës dhe thërret në mbledhje anëtarët e Këshillit të Mbrojtjes, si dhe e drejton vetë atë.

Neni 8

Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura ka këto kompetenca kryesore:

1. Miraton planin operativo-strategjik të mbrojtjes së vendit.

2. Emëron, transferon dhe vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj oficerëve të lartë me gradë gjeneral.

3. Me propozim të Këshillit të Ministrave emëron dhe shkarkon shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë.

4. Urdhëron vendosjen e shkallëve të ndryshme të gatishmërisë luftarake në të gjitha Forcat e Armatosura ose në një pjesë të tyre, në rast rreziku të luftës apo në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme.

5. Urdhëron lëvizjen, dislokimin dhe përdorimin e Forcave të Armatosura në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme.

6. Urdhëron dhënien e sinjalit të kushtrimit ajror në të gjithë territorin e vendit.

7. Urdhëron për hapjen e zjarrit mbi forcat e mjetet tokësore, detare dhe ajrore të huaja, kur ato sulmojnë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Me propozimin e Shtabit të Përgjithshëm vendos për përdorimin e Forcave të Armatosura në operacionet ushtarake.



Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 11.12.1991

Nr. i ligjit: 7528

KRYETARI I KRYESISË
Kastriot Islami

LIGJ

PËR SHFUQIZIMIN E LIGJIT NR. 7383, DATË 8.5.1990, “PËR GJYKATAT SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ligji nr. 7383, datë 8.5.1990, “Për gjykatat shoqërore”, shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 11.12.1991

Nr. i ligjit: 7529

KRYETARI I KRYESISË
Kastriot Islami

LIGJ

PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT INFORMATIV USHTARAK DHE TË SHËRBIMIT TË KUNDËRZBULIMIT NË ORGANET E RENDIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ushtri organizohet Shërbimi Informativ Ushtarak në vartësi të ministrit të Mbrojtjes. Në

forcat e Ministrisë së Rendit Publik organizohet Shërbimi i Kundërzbulimit në vartësi të ministrit të Rendit Publik.

Neni 2

Shërbimi Informativ Ushtarak si organ i specializuar informativo-gjurmues, organizohet në njësitë operative, taktike e në reparte, në qendra informative të shtrira sipas objekteve të punës, të cilat varen drejtpërsëdrejti nga drejtoria përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në vartësi vertikale operative nga komandat përkatëse. Drejtimet dhe objektivat kryesorë të punës të Shërbimit Informativ Ushtarak miratohen nga Këshilli i Mbrojtjes.

Ndërtimi, objektet, detyrat dhe kompetencat e hallkave të këtij shërbimi përcaktohen me udhëzim të veçantë nga ministri i Mbrojtjes.

Neni 3

Shërbimi i Kundërzbulimit në organet e Rendit Publik ka organet e tij nga qendra në bazë.

Struktura, detyrat dhe kompetencat e tij përcaktohen nga ministri i rendit Publik.

Neni 4

Shërbimi i Kundërzbulimit në organet e Rendit Publik siguron të dhëna për të zbuluar, parandaluar e ndërprerë veprimtarinë antikush-tetuese, që realizohet nëpërmjet formave të spiunazhit, diversionit, sabotimit e vepra të tjera të tilla dhe zhvillon luftën kundër kriminalitetit në organet e Rendit publik e në repartet e tyre.

Neni 5

Shërbimi Informativ Ushtarak siguron të dhëna për mbrojtjen e vendit në planin ushtarak nga çdo agresion i jashtëm, si dhe për të zbuluar, parandaluar e ndërprerë veprimtarinë antikushetuese, që cenon pavarësinë, aftësinë mbrojtëse, tërësinë territoriale dhe pasurinë ushtarake, e cila zhvillohet nëpërmjet formave të spiunazhit, diversionit, sabotimit, korrupsionit politik, rrëzimit me dhunë të rendit kushtetues, përgatitjes për provokimin e luftës, si dhe veprave kriminale që drejtohen kundër ushtrisë ose zhvillohen brenda radhëve të saj.

Neni 6

Organi i Shërbimit Informativ Ushtarak, për funksionimin normal dhe kryerjen me efektivitet



të detyrave të tij, me miratim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, përdor mundësitë që kanë ministrinë, institucionet qendrore dhe organet e tjera të administratës shtetërore.

Neni 7

Shërbimi Informativ Ushtarak dhe Shërbimi i Kundërzbulimit në organet e Rendit Publik janë të detyruar të bashkëpunojnë e këmbejnë informacion për punën informative me interes të përbashkët si ndërmjet tyre ashtu dhe me Shërbimin Informativ Kombëtar, si dhe me ministrinë e institucionet e tjera qendrore.

Neni 8

Shërbimi Informativ Ushtarak dhe Shërbimi i Kundërzbulimit në organet e Rendit Publik, në veprimtarinë e tyre, zbatojnë dispozitat që parashikon ligji nr. 7495, datë 2.7.1991, “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, në kreun I, nenet 3, 4, 5, 6, 7 e 8 dhe në kreun III, “Të drejtat dhe detyrat e Shërbimit Informativ Kombëtar dh të punonjësve të tij”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 11.12.1991

Nr. i ligjit: 7530

KRYETARI I KRYESISË
Kastriot Islami

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë